

REXHEP HOTI
KOHË E PRERË
ROMAN

BOTIMET TOENA

Libra nga Rexhep Hoti
prej Shtëpisë Botuese TOENA

- Nata e Kosovës
- Tempulli i fjalës
- Pesha e konsensusit
- Kohë e prerë

Rexhep Hoti

Kohë e prerë

roman

Parathënie nga **Helena Kadare**

Pasthënie nga **Ndue Lazri**

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Korrektorë letrarë: Ekrem Kryeziu dhe Majlinda Bami

Kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 978-9928-817-37-2

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Parathënie

Përjetësimi i Ukshin Hotit në letërsi

Rexhep Hoti ka sjellë gjithnjë Kosovën në familjen tonë. Në Parisin e viteve 1998-1999, ai na sillte atmosferën e trishtë të luftës, me lajmet që shtonin ankthin për gjithçka ndodhte, bashkë me padurimin për orë më të mira. Largësia gjeografike fizike mes Parisit dhe Prishtinës bëhej e padallueshme, sigurisht jo prej shkronjës së parë të përbashkët, por për shkak të përjetimit shumëdimensional.

Politika mbi ndodhitë e viteve të vështira '98-'99 i linte vendin natyrshëm njerëzores së Rexhepit me tregimet dhe dëshmitë e gjalla që na afronin njerëzisht dhe shpirtërisht me Prishtinën dhe Kosovën e dashur, të përvuajtur, por me zemrën kombëtare të mbushur me besimin e palëkundur mbi mëvetësinë. Prej tij, emri i Ukshin Hotit, intelektualit dhe mendimtarit që ideoi hartën e një Kosove të lirë e të pavarur, do të ishte më i pranishëm thellësisht në bisedat tona, në kohë jo të lehta për të.

Një nga njerëzit më të afërt të Ukshinit, Rexhepi, kishte marrë prej tij urtësinë e mendimit, gjë që e ruan ende sot. Libri që Ismaili shkroi me të, "Bisedë përmes hekurave", e përshkruan më së miri përmasën e jashtëzakonshme që ky

Rexhep Hoti

intelektual kishte për Kosovën. Por, përmes Rexhepit, ne njohëm dhe dimensionin e madh human të këtij filozofi, që ashtu si në shumë raste në jetën tonë, kam kuptuar se një njeri i lartë është i lartë në të gjitha raportet, ashtu siç e kishte të paanë fljimin për lirinë.

Një paradite shkurti ai erdhi në apartamentin tonë në Tiranë bashkë me një dorëshkrim që e mbante në duar, me besimin e madh se duhej ta lexoja. Kur më tha se ka bërë një roman ku personazh është vetë Ukshini, me droje i premtova se do ta lexoja. Ende pa e shfletuar, me mbeti i varur në mendje titulli i romanit “Kohë e prerë”, sikur përmasa e asaj çarjeje që e bartte ai togfjalësh të ishte shndërruar në një univers në vete sfidues, jo vetëm për botën e të gjallëve por edhe për botën tjetër të përtejme. Në të vërtetë edhe sot e këtë ditë i tillë mbetet fati i Ukshin Hotit, një kohë e prerë e njeriut të pagjetur.

Romanet biografikë apo bazuar në histori të vërteta njerëzore gjithnjë janë një kurth për shkrimtarët. Kufiri mes artit dhe së vërtetës ndonjëherë është aq i padukshëm, por dhe aq i rëndësishëm, pasi letërsia ka të vërtetat e saj universale. Me këtë rast ndërlikueshmëria e ndërthurjes së kufijve ndërmjet botës reale dhe imagjinare peshojnë si gur në vendin e vet dhe letërsia është më e pasur me “Kohën e prerë”.

Duke lexuar romanin e Rexhepit do të endesha në një kronikë të shkruar plot kulturë e stil, me një poetikë të natyrshme për një prozator që vjen nga poezia, që të bënte të jetoje atë që është aq me vlerë në një vepër: kënaqësia e leximit dhe kodi i saj suprem. Duke e sjellë si një personazh letrar, ai i jep Ukshinit me këtë libër një tjetër jetë që është jeta që të jep letërsia artistike. Jam e bindur që ky roman do të ketë jetën e vet në duart e lexuesve, duke i ftuar ata në vazhdimësi që të njohin më tepër figurën më të shtrenjtë të martirizuar për shqiptarët dhe një kontribuues të madh në historinë e Kosovës, Ukshin Hotin. Prej këtij libri rrjedh e pasur dhe e veçantë bota estetike e letërsisë shqiptare dhe europiane njëkohësisht, ku

Kohë e prerë

heroi i flijimit, siç është karakteri i Ukshinit, hap horizonte të shtresuara nëpër të cilat jetësohet pesha e mendimit të bukur. Romani “Kohë e prerë”, e sjell mendimin filozofik mbi çështjen e qytetërimit shqiptar european të Ukshin Hotit në botën e trajtesës artistike, e cila përjetësohet në universin e letërsisë me gjuhë, teknikë e figura letrare, që nga gropa ku ai do të mbahet i lidhur me hekura, te gjeneralët e paftuar e gjer te brenga për fëmijët a të ardhmen e trungut etnik të heroit. Letërsia është jeta që doja, me siguri këtë thënie të Kantit, Ukshini duhet ta ketë lexuar, e me këtë roman do ta ketë përgjithnjë.

Helena Kadare

Mars 2024

Kreu i parë

Hkshini e kishte zbrazur taketuken e duhanit dhe e kishte larguar xhezven me gjithë filxhanin e kafesë, sepse i dukej sikur po i krijonin rrëmujë dhe kjo ishte njëra prej shprehive, të cilën e përsëriste, kur ndodhej vetëm në shtëpi, për disa herë gjatë ditës. Atë natë ai priste që të vinte një mysafire e veçantë dhe kjo kishte qenë edhe arsyeja që e kishte përcjellë R-në, kushëririn e tij, më herët se zakonisht. Edhe ashtu, në sallonin e shtëpisë së re nuk kishte çfarë të largonte më shumë, pasi nuk e kishte mobiluar ende. Ish-ministri i punëve të Jashtme të Kosovës, i sapokthyer nga burgu në Krushë të Madhe, kishte rënë jo vetëm nga majat e politikës, por edhe prej institucioneve akademike ku ligjëronte. Edhe më keq se kaq. Në trysninë e tmerreve të gropës në hekura dhe të informacioneve shpeshherë të rreme për bashkëshorten dhe rreth saj, e kishte kërkuar zyrtarisht edhe ndarjen me të, pak muaj para se ta kryente dënimin.

Dhe kur u lirua, njeriu që kishte humbur gjithçka, kishte mbetur praktikisht në mëshirën e të tjerëve, të familjes, të afërmeve, njerëzve të caktuar brenda fshatit apo jashtë tij. Veçmas ishte bërë barrë e babait të moshuar, Zyfës, i cili kishte një kioskë të vogël prej katër metra katrorë. Ai duhej të kujdesej edhe për djalën e vet dyzetetrevjeçar, tashmë të shkurorëzuar, të përjashtuar nga puna universitare, të larguar nga apartamenti

Rexhep Hoti

në Prishtinë, krahas djalit tjetër më të voglit, të cilin e kishte pasur gjithashtu në burg. Për Zyfën, që e mbante plisin të bardhë vetëm për raste solemne, kur i dolën djemtë nga burgu, u bë edhe më keq, jo vetëm nga ana ekonomike e sociale, por i humbi edhe rehatia në shtëpi, drejtimi i së cilës u bë tepër i zorshëm. Para Ukshinit kishte rënë në burg Zyfës djali më i vogli për nga mosha, Afrimi, që në kohën kur ishte gjimnazist, nën moshën madhore. Ai ishte dënuar katër vjet e gjysmë si kundërrevolucionar për shkatërrimin e Jugosllavisë, i cili, çështë e vërteta, as nuk kishte ndonjë përkushtim ndaj shkollimit, por edhe jetën e vet e bënte për të tjerët. Botën e shihte thjesht jashtë rrjedhës së saj reale. Ndoshta kjo mënyrë e jetës ia kishte imponuar edhe natyrën e trillimit, si një ves natyral, të cilin e bënte me përkushtim. E pavërteta tek ai rridhte në mënyrë të vetvetishme dhe kreative. Prandaj duhej një kohë gjersa binte në sy kjo aftësi e heshtur e tij për t'i ofruar gjërat e pavërteta si të vërteta. E kishin zënë në demonstratat në Prizren dhe e kishin futur në burg, si shumë nxënës të tjerë, që në atë kohë binin nëpër burgje nën moshën madhore.

Natyrisht, një mbështetje të pashëndetshme rritjes së tij ia kishte dhënë edhe fakti se ishte i vëllai i vogël i Ukshinit. Në fillim i vëllai e përdorte përkatësinë biologjike, siç e përdorte e gjithë familja, si një mundësi për t'iu hapur rrugët kudo. Por kur ra Uka në burg gjërat ndryshuan dhe përdorimi i pozicionit të vëllait të madh kaloi në anën e pushtetit. Kishte shumë thashetheme në qoftë se burgosja e tij ishte një kurth për vetë Ukshinin. Kjo ishte një natyrë më tepër e botës konspirative dhe e vërteta brenda saj ishte gjithmonë jo e plotë dhe mjegulluar. Në anën tjetër, përpjekjet e Ukshinit për t'iu përshtatur në familje e në fshat, duke e ngarë traktorin, herë pas here, të cilën punë dinte ta bënte më mirë se të tjerat, se puna e shatit apo e lopatës, fjala vjen, nuk i shkonte për dore dhe me të s'mund të siguronte gjë. Vetëm sa torturohej kot, sepse me shat apo me ngasjen e traktorit, për aq sa përkushtohej ai, s'ishte

Kohë e prerë

e mjaftueshme për t'i sjellë mirëqenie ekonomike ish-ministrit të punëve të Jashtme të Kosovës, i cili natyrën e botës akademike e kishte pasur përkushtimin e parë e të vetëm në jetë.

Kur akrepat e orës kishin hyrë në orën e mesnatës, atij i ishin zbehur shpresat që ajo do të vinte. Ndoshta do ta ketë ngatërruar datën, pasi në kohën kur duhej të vinte, siç e kishte njoftuar ajo me një pusullë të shkurtër, ishte koha kur ndërrohej edhe data. Duke u bërë gati të shtrihej në shiltet e holla, që ia kishte sjellë nëna Timë, pa e pyetur, në të kundërtën nuk do t'i pranonte, e kishte ngritur shilten e fundit dhe e kishte futur nën të “Encyclopédie de la philosophie”. Ky ishte një libër voluminoz të cilin e shfletonte shpesh, por në atë rast i shërbente edhe si jastëk. Në çastin që ishte bërë gati të shtrihej e kishte dëgjuar përjashta zhurmën e rëndë të një motori, të cilin nuk mund ta përcaktonte se çfarë lloj makine mund të ishte. I kishte bërë përshtypje ajo uturimë e motorit, e cila ia krijonte ndjesinë se ia dridhte edhe dyshemenë nën këmbë dhe ajrin përreth. Veçmas në hapësirën e zbratur të sallonit, oshtima dukej sikur përplasej më thekshëm në dërrasat e thata e të latuara dhe depërtonte nëpër linjat e ndërlidhjes së drunjtë nëpërmjet gojëve dhe që andej, zhurma merrte ngjyrimë tingujsh sikur të dilte nga vrima magjike e kitarës. Në momentin që ishte përqendruar i tëri për ta dëgjuar se çfarë ishte ajo uturimë, në errësirën e lodhur të mesnatës, motori i makinës së paidentifikuar prej tij, ishte fikur. Në vend të saj, kishin filluar të dëgjoreshin qartë hapa të rëndë njerëzish, të cilët padyshim duhej të kishin një muskulaturë shumë të përpunuar të këmbëve.

Meqë çapitjet që sa vinin e dëgjoreshin gjithnjë e më qartë edhe për nga mënyra se si e rrihnin ato truallin me këmbë, dëshmonte për një ritëm të ushtruar prej kohësh. Ai e kishte ndierë se ata njerëz të panjohur, të cilët kishin ardhur me uturimë motori të çuditshëm, mund të ishin mysafirë të tij, pasi

Rexhep Hoti

s'kishte tjetër shtëpi aty afër. Pa pasur kohë që ta shtjellonte më tutje mendimin, trokitjet e rënda në derën e shtëpisë, sikurse edhe hapat e tyre, ia kishin tërhequr vëmendjen plotësisht. Kishte shpejtuar te dera e hyrjes, si të kërkonte të parandalonte rrjedhën e një ngjarjeje të keqe. Në fillim ishte matur ta ndizte dritën e oborrit, por kishte hequr dorë, ngase mund të kishte pamje më të mirë sikur të përshtatej me dritën që do të dilte me rastin e hapjes së derës. Në atë mënyrë pamja për të do të kishte një thellësi më të madhe shikimi dhe përparësia nuk do të ishte vetëm në pjesën matanë. Ai gjithmonë e linte dritën e oborrit ndezur, me përjashtim të rasteve kur priste ndonjë mysafir, i cili, ose kishte frikë të shihej se po vinte tek ai prej pushtetit, ose do të duhej të ishte ndonjë person që ai vetë nuk e dëshironte që të shihej prej të tjerëve. Në këtë natë kishte qenë pikërisht arsyeja e fundit që ai nuk e kishte ndezur dritën. Nuk duhej të shihej njeriu që e priste të vinte pas mesnate nga banorët përreth a prej kalimtarëve të rastit. Kur e kishte hapur derën, para tij ishte shfaqur një pamje e cila nuk i kishte ndodhur ta shihte ashtu, që prej kohës kur kishte qenë ushtar i Jugosllavisë. Matanë pragut qëndronte një oficer i lartë, gradat e të cilit nuk ia kishte dalluar qartë, veçse ia kishte vërejtur kalimthi disa yje të rrethuar me kurorë dafine në krah. Ai e kishte kuptuar se kishte të bënte me një gjeneral, të cilin e shoqëronin dy ushtarë të armatosur, por të cilët i mbanin kallashnikovët në krah dhe, që të dy, kishin edhe revole në brez. Dy hapa para tyre qëndronte oficeri ushtarak, në dukje krejt paqësor, i cili, ndonëse ishte i veshur me uniformë ushtarake, nuk vihej re të kishte asnjë lloj arme në brez. Përveç që dukej se nuk mbante armë, nuk kishte as edhe një nishan në pjesën e majtë të gjoksit, sikur të mos kishte marrë kurrë ndonjë urdhër, çmim a shenja të tjera gradimi.

“Mirëmbërëma! Çfarë mund t’ju ndihmoj, zotërinj”, u kishte thënë në gjuhën serbokroate Ukshini, pa pritur që ushtarakët përballë tij ta fillonin komunikimin.

Kohë e prerë

Natyrisht, binte në sy kureshtja e tij për të kuptuar se çfarë kërkonin në këtë orë kaçakësh, ushtarakët jugosllavë. Aty për aty, ende pa marrë përgjigje nga pala tjetër, iu kujtua paralajmërimi i shërbimit inteligjent ushtarak në burgun Qendror të Beogradit se, edhe pasi ta kryente burgun, do t'i kishte kohë pas kohe gjeneralët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë si vizitorë në shtëpinë e tij në Krushë të Madhe. Kështu kishte qenë dikur mesazhi. Kishte vite që kishte ndodhur ky paralajmërim gjatë kohës gjersa kishte qenë në burgun hetues.

Ishte njëra prej kohëve më të vështira që Ukshini kishte pasur në jetën e tij, sepse gjatë asaj periudhe, ndër torturat e shumta që kishin aplikuar hetuesit jugosllavë kundër tij, kishte qenë edhe metoda e torturës së pagjumësisë. Qelia ku kishte qenë i mbyllur, ishte pa dritare dhe muret e saj ishin të veshura me një masë të tillë sfungjorore, e cila ishte izoluese ndaj zërit. Mund të bërtisje me një fuqi të tillë, që piskama të arrinte deri në kupën e qiellit, por, në të vërtetë, ajo mbetej aty, në atë hapësirë rreth 15 metra katror.

“Dhe e dinë cili ishte kulmi i ironisë së mureve të veshura me sfungjer”, i thoshte ai R-së, kur ia rrëfente tmerrin e torturave. “Ato shërbenin edhe për sigurinë e të burgosurit, çka do të thotë se ai s’duhej të kishte mundësi që të bënte vetëvrasje. Edhe po të merrte vrull vrap e të godiste me krye murin, me gjithë fuqinë që mund të ketë një i burgosur i rraskapitur, tek e shumta mund t’i binte të fikët”.

Përshkrimi i tij në qelinë hetimore të izolimit ishte rrëqethës. Ai i kishte treguar R-së se e gjithë historia e operimit të hernies gjatë kohës sa ishte në burg, ndërlidhej me torturën që i kishin bërë në organet gjenitale, të cilat ia kishin lidhur me tel dhe ia kishin tërhequr e shtrënguar aq shumë, saqë një kohë të gjatë kishte qenë i detyruar të rrinte i shtrirë në spital. Më e keqja e kësaj torture kishte qenë infektimi i plagëve që i ishin shkaktuar prej depërtimit të telit në mish.

Rexhep Hoti

Kjo nuk ishte metodë e izoluar, por mjaft e shpeshtë, me të cilën i kishin torturuar shqiptarët nëpër burgje të ndryshme dhe në kohë të ndryshme të Jugosllavisë. Ukshini ishte njohur me tortura të tilla kur kishte lexuar për ndëshkimet dhe masakrat shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe fill pas saj. Sidomos në epokën famëkeqe të Rankoviqit. E vërteta ishte se kjo torturë, megjithatë, nuk ishte më mizorja, që ai e kishte përjetuar. Ajo ishte kryesisht një torturë që shkaktonte dhimbje fizike dhe për të tilla, Ukshini, ishte aq i qëndrueshëm sa mund t'ia hiqte mishin copë-copë nga trupi dhe të mos jepej fare. Por, përgjatë procesit të burgut hetues, më vonë, ia kishin sjellë një listë me mbi 400 personalitete për ta nënshkruar, gjoja se ata kishin qenë bashkëpunëtorët e tij për organizimin e demonstratave armiqësore, kundërrevolucionare e irredentiste të vitit 1981.

Shërbimet jugosllave dhe serbe përgjithësisht e mbronin mendimin se masiviteti i demonstratave kishte qenë i tillë, që e implikonte krejt strukturën drejtuese politike e intelektuale të Kosovës. Ose atë strategji ata e synonin që ta realizonin për t'i pasur të gjithë në një thes. Në krye të asaj liste ishte Mahmut Bakalli, i pasuar nga Fadil Hoxha dhe pjesa tjetër më e rëndësishme e elitës së Kosovës. Kur hetuesit e kishin konstatuar se Ukshini nuk do të pranonte në asnjë mënyrë që ta nënshkruante listën e ofruar, atëherë e kishin aplikuar torturën me dritë, atë që të vret në shikim dhe të lë pa gjumë. Nëpërmjet reflektorëve, drita binte drejtpërdrejt në sy, të cilët ia mbanin dhunshëm të hapur dhe nëpërmjet zhurmës, që ishte një kuisje e veçantë e derës së qelisë, e cila kur hapej dhe mbyllej, e kishte efektin e shkaktimit të dhimbjes sikur të ta grinin me sharrë gjithë sistemin nervor të organizmit.

“Koha e hapjes dhe mbylljes së kësaj dere të hekurt, ishte aq e ngadaltë dhe aq e gjatë, sa mua më dukej se zgjaste një natë”, i thoshte R-së. Ishte e habitshme se në të dyja rastet, që ia kishte rrëfyer torturën gjatë kohës së burgut hetues, edhe pas

Kohë e prerë

gjithë atyre viteve që kishin kaluar ato ngjarje, nuk ia kishte treguar kurrë i ulur. Përgjatë rrëfimit, ai gjithmonë ecte në një rreth jo më të madh se tre-katër metra në diametër, dhe ashtu, ndërsa pinte duhan, fliste me dridhjen e mjekrës që ia shoqëronte dridhjen e zërit vazhdimisht. Në të vërtetë ai e imitonte ecjen nëpër qeli edhe pse nuk e thoshte shkoqur.

“Në një rast më kishin lodhur deri në fuqitë e fundit me torturën e pagjumësisë. Ajo mendoj se është kryetortura. Më e poshtra, më e liga, më e tmerrshmja. Është vërtet “fucking shit”, që thonë amerikanët. Sepse dhimbja është tërësisht komplekse fizike, shpirtërore e psikike njëkohësisht...”

Kushëriri, teksa e dëgjonte fabulën e torturës së burgut hetues për ta implikuar gjithë elitën politike e intelektuale të vendit në ngjarjet e vitit 1981, mbledhëj kruspull sikur të kërkonte të mbrohej nga tmerri i asaj historie të lemerisur që shpaloste tjetri. Mbulohej i tëri me djersë dhe ndoshta ky ishte kompromisi i të qarit të tij, në vend të lotëve. Nuk mund ta besonte se deri në çfarë pike mund të zbriste mendja e njeriut, për ta munduar një qenie të pambrojtur e të lidhur në hekura, vetëm pse në një mbledhje të universitetit e kishte shprehur mendimin hapur mbi ngjarjet e vitit 1981.

“E kisha listën me mbi 400 emra personalitetesh përpara dhe nënshkrimi i saj do të thoshte burgosje e tërësishtme e establishmentit të vendit praktikisht. Në anën tjetër, kisha një letër prej Ekrem Kryeziut, i cili me inkurajonte që ta nënshkruaja “atë mut liste” se të gjithë ata pisa që ndodheshin në listë e që ndodheshin jashtë, nuk meritonin fat tjetër. Aq më tepër që ishte i bindur edhe Halil Alidemaj, të cilin e kishin rrahur aq shumë në këmbë dhe në shputa, sa nuk mund të ecte fare më. E kapnin për krahësh, si të ishte një kufomë dhe e tërhiqnin zvarrë. Ai mendonte gjithashtu se me nënshkrimin e saj, do të sensibilizohej çështja gjer në përmasa të pakthyeshme të proceseve, dhe në këtë mënyrë do të fitonte vendi. Më mirë të shkojë në burg elita e Kosovës se rinia e

Rexhep Hoti

pa fajshme e saj, më thoshin duke arsyetuar ata. E vërteta ishte se unë edhe po të isha i bindur se ai nënshkrim do ta sillte Republikën, nuk do të mund ta nënshkruaja kurrë. Ishte thjesht një shpikje dhe s'mund të rroja me atë trillim më pas. Natyrisht, këtë nuk e kupton as Ekremi e as Halili, me të cilët kurrë nuk kam bërë asnjë organizim të fshehtë e të përbashkët kundër shtetit të Kosovës, të Serbisë apo të Jugosllavisë. Thjesht ishim miq dhe kemi pasur biseda miqsh dhe asgjë më shumë.”

Kushëriri i ri, që kishte hyrë i tëri në kohën e qelive të burgjeve hetuese, e kishte të vështirë ta përpunonte shpirtërisht gjithë informacionin që derdhej si një llavë vullkanike mbi shpirtin e tij. Në ndonjë çast i kërkonte Profesorit që ta pushonte rrëfimin, ta ndizte një cigare derisa ai ta kryente një vrapim. Kishte ndjesi të njëmendët se zemra do t'i shpërthente në mijëra copa po të mos vraponte për ta shkarkuar gjithë atë energji që i grumbullohej, si t'i derdhej një lumë në gjoksin e tij dhe të mbetej aty.

“Po përse nuk mjaftoheshin serbët me nënshkrimin e Ekremit dhe të Halilit atëherë, kur ata i kishin dy nënshkrime?”, i kishte ndërhyrë ndërkohë me pyetje R-ja.

“Ju duhej nënshkrimi im, sepse unë isha i vetmi i kategorisë së lartë që vija edhe nga shtresa intelektuale, e edhe nga pozita e një funksionari të lartë shtetëror, pra nga linja politike. Nënshkrimi im ishte i besueshëm për ta përfshirë klasën politike e intelektuale njëherësh, gjë që këtë peshë nuk mund ta kishte një regjisor, siç ishte Ekremi, apo një referent i fakultetit, siç ishte Halili.”

“Më bën kureshtar të të pyes, përse e kanë vënë në listë së pari Mahmutin e jo Fadil Hoxhën, kur ky ishte me funksione më të larta në federatën jugosllave?”, e kishte pyetur i riu, gjykuar mbi bazën e asaj çfarë kishte mësuar prej Profesorit.

“Ha, ha, ha...”, kishte qeshur me të madhe. Mbase nga nevoja që edhe ai të shfryhej sadopak. “Je vërtet lëkura e keqe! Kjo më pëlqen! Do të thotë se ke filluar të kuptosh kur diçka

Kohë e prerë

duhet të pyesësh, që ndonjëherë është më e thellë sesa ajo që vjen pas”, i ishte përgjigjur ai. “Mahmuti duhej të ishte i pari, sepse ai ishte i pari i Komitetit dhe përgjegjësia e demonstratave duhej të binte ekskluzivisht mbi pushtetin e Kosovës. Këtë qëllim kishte Serbia. Të bëhej përgjegjës shteti në mënyrë që asaj t’i hapej rrugë për shpartallimin e autonomisë, pra të shtetit, që i kishte ikur asaj prej dore më 1974, me Kushtetutën e saj, e cila i garantonte lidhje të drejtpërdrejta edhe me federatën jugosllave, nëpërmjet elementit konstituiiv. Ajo që deshi Beogradi më vonë u dëshmuua katërçipërisht. Fadili ishte me përgjegjësi federative dhe gjykimi i tij duhej të ishte i tërthortë. Kjo do të thoshte, duhej të ndëshkoheshin njerëzit e tij e bashkë më ta, më pas, edhe ai që i kishte zgjedhur.”

Përgjatë rrëfimit Profesori ndalej kohë pas kohe. Priste të merrte ajër në mënyrë që edhe mjekra e tij të qetësohej sadopak. Në raste të caktuara, për ta larguar atë nga ajo pozitive e palakmueshme, R-ja e kishte gjetur një krahasim për t’i thënë se emocioni i mjekrës së tij ishte diçka e veçantë. I thoshte se ky fenomen ia kujtonte Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, i cili kur zemërohej shumë i rridhte gjak prej mesit të buzës së poshtme.

“Ti nuk je Gjergj, por këshilltar i tij mund të ishe! Mendoj unë”, i thoshte ai, duke u përpjekur që ta vinte mahinë në shërbim të gjendjes së rëndë emocionale. Ndonëse mendime të tilla i thoshte për ta shtendosur sadopak gjendjen e rëndë, nga mënyra se si përmbylleshin ato përballë gjendjes së ngarkuar, më tepër merrnin ngjyrimë groteske.

Thjesht, as edhe heshtja s’kishte fuqi të përballej me to. Tjetri nuk thoshte gjë. E ndërronte duqin nga kamishi qelibar dhe e fuste cigaren tjetër, e ndizte dhe më pas vazhdonte.

“Siç të thashë më herët, kur më dërrmuan dhe më shtrinë për tokë nëpërmjet torturës së pagjumësisë, atëherë, aty për aty, më ra ndër mend një ide, e cila, do të ma mundësonte

Rexhep Hoti

një pushim prej njëzet e katër orësh, të paktën, aq kohë sa do t'u nevojitej shërbimeve të inteligjencës jugosllave dhe serbe për verifikimin e saj. U kërkova një letër dhe një laps dhe u thashë se listën, që ata e kishin bërë gati me mbi 400 emra, s'mund ta nënshkruaj, por mund t'u jepja një informacion tjetër, që kishte peshë dhe rëndësi ndërkombëtare.”

Natyrisht, hetuesi i ndërrimit ishte gëzuar aq shumë, sa Ukshini nuk e kishte kuptuar fare prej nga e kishte siguruar aq shpejt një letër të bardhë, formati A-4, dhe një stilolaps. Në të vërtetë hetuesit, me ta dëgjuar informacionin “me rëndësi ndërkombëtare”, i kishte ardhur shumë i besueshëm, duke u mbështetur në të dhënat dhe rolin që kishte pasur Ukshini si ekspert federativ për çështje ndërkombëtare. Madje, ishte specializuar në trurin e kapitalizmit botëror, siç ishte Harvardi.

“Po kjo është punë, shoku Ukshin! Përse e torturoni veten duke mos e treguar të vërtetën?”, ia kishte bërë ai dhe ia kishte zgjatur letrën me stilolaps. Të burgosurit i kishte bërë përshtypja mënyra e formulimit të hetuesit, se ai ishte duke e torturuar veten, sipas tij, e jo njerëzit e shtetit. Çfarë logjike, kishte thënë vetë me vete.

“Ua dhashë informacionin se isha pjesë e “Brigadave të Kuqe”, të cilat vepronin në Itali, dhe se kisha marrë për mision shkatërrimin e Jugosllavisë, duke e nisur lëvizjen për këto procese të rëndësishme së pari nga Kosova.”

Hetuesi i ndërrimit mezi e kishte pritur nënshkrimin dhe në çast ishte larguar nga burgu, duke lënë kujdestar një gardian të zakonshëm, të cilin e kishte porositur që ta nxirrte Ukshinin nga qelia e izolimit dhe ta dërgonte në një qeli normale. Ai tashmë kishte qenë i bindur se qëllimi ishte arritur, e Ukshini i pamposhtur ishte thyer.

Pas njëzet e katër ore saktë, në qelinë e tij ishte dukur një njeri krejt i veçantë. Ai nuk ishte as hetues dhe as njeriu i shërbimit që kishte qenë më parë, por ishte prezantuar si këshilltari i gjeneralmajorit S., i cili kishte ardhur për t'ia

Kohë e prerë

përcjellë një porosi të burgosurit që ta mbante mend mirë tash e tutje.

“Zoti Ukshin, më lejoni t’ju prezantohem: quhem Zvonko Obradoviq, zyrtar në armatën jugosllave. Ju njoftojmë se do të të kemi nën kujdes ditor edhe kur do të jeni në Krushë të Madhe, pasi ta kryeni burgun, ku edhe do të jetoni. Ju lutem këtë ta mbani ndër mend dhe të mos e harroni mesazhin tonë kurrsesi. Nuk është gjë tjetër, pos një procedurë shtetërore ndaj jush, dhe të cilën do ta zbatojmë me përpikëri. Kjo është porosia që më duhet t’ju përcjell nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë”, pa saktësuar më tutje nëse bëhej fjalë për federatën jugosllave apo për Serbinë.

E kishte përshëndetur sërish me plot respekt dhe ishte zhdukur. Natyrisht biseda e faktorëve të ndryshëm që vinin nga ana e fushës së hetimeve dhe e natyrave të tjera, bëhej gjithmonë dhe drejtpërdrejt në gjuhën serbokroate. Ukshini, i cili kishte studiuar edhe në shkollën e Zagrebit e edhe në atë të Beogradit, nuk e kishte për telashe të fliste madje edhe me nënvizime kur fjalët serbe të mos i ngatërronte me ato kroate, në varësi të palës që kishte përballë. Nga prezantimi i këshilltarit, që ishte prezantuar si njeriu i gjeneralit, i kishte bërë përshtypje përdorimi i fjalës “zotëri” në vend të fjalës “shok”, siç ishte e parapëlqyer në sistemet komuniste.

Që nga ajo kohë nuk i kishte ndodhur të kishte më torturë të pagjumësisë dhe kishin pushuar të gjitha torturat e tjera. Si duket trajtimi i tij kishte marrë një rol tjetër nga çasti i lojës me “Brigadat e Kuqe”. Ukshini nuk ishte më njeri i rrezikshëm sa për t'u torturuar.

Ai kishte hyrë në një mekanizëm të mbikëqyrjes, e cila mund të shembej vetëm me shembjen e shtetit, ose me bashkëpunimin e këtij të fundit me autoritetet e ushtrisë, që e kishte nën kontroll absolut shtetin jugosllav. E vërteta është se në atë kohë, Ukshini, këtë mesazh e kishte marrë si një zemërim të çastit të atyre që i kishte vënë në lajthitje në lidhje me

Rexhep Hoti

“Brigadat e Kuqe”, dhe, se nuk besonte që do të ndodhte ajo çfarë i kishte thënë këshilltari i gjeneralit serb. Aq më pak e kishte besuar konstatimin se ai do të jetonte në fshat, kur e kishte apartamentin dhe familjen e tij në Prishtinë. Madje kjo pjesë i ishte dikur edhe absurde. A është e mundur që ky të jetë njeriu që ma kishte dërguar këshilltarin e tij në burgun e hetimeve, kur isha në Beograd, kishte menduar vetë me vete, ndërkohë që ushtaraku kishte filluar të fliste me tone të përzemërta.

“Mirëmbërëma, zoti Ukshin”, ishte dëgjuar përshëndetja e oficerit serb. “Para se të prezantohem, më lejoni që t’ju kërkojmë falje për ardhjen në këto orë të vona të natës”.

Kjo mënyrë e fillimit të bisedës i kishte dhënë shenjë tjetrit se ata kishin ardhur kaq vonë, nga shkaku se dëshironin të hynin brenda në shtëpi.

“Urdhëroni”, ia kishte bërë Ukshini pa humbur kohë, duke u larguar prej hyrjes në skaj dhe duke e hapur derën deri në fund. Iu duk shumë e papërshtatshme ajo pamje, e cila ngjante me tufën e mushkonjave, të cilat fluturojnë duke u vërtitur përreth llambës elektrike të vendosur në pjesën e sipërme të derës së shtëpisë, si rituali i vallëzimit të Semas së Mevlanës.

“Faleminderit”, kishte thënë tjetri, në çastin që po e hidhte edhe hapin drejt hyrjes, si të ishin zëri dhe lëvizja fizike një bashkëveprim i domosdoshëm në këtë rast.

Por, ndërsa ushtaraku i lartë kishte hyrë brenda, pas tij nuk po hynte më njeri tjetër. Në të vërtetë kishte ndodhur e kundërta. Në kohën që komandanti kishte qenë duke hyrë, ushtarët ishin larguar në drejtime të kundërta me të. Njëri ishte nisur andej prej nga mund të vëzhgohej pamja e jashtme e shtëpisë, aty pranë ku e kishin ndalur në rrugë edhe picgauerin ushtarak, kurse tjetri ishte nisur nga pjesa e prapme e saj. Ukshini kishte mbetur një kohë te dera, ashtu, duke parë, se si dy ushtarët që e përcillnin komandantin e tyre, jo vetëm që nuk

Kohë e prerë

kishin hyrë së bashku me të, por kishin marrë drejtime të cilat i kishin pasur më parë të caktuara.

“Le të rrinë jashtë! Më mirë kështu”, i ishte drejtuar ushtaraku i lartë, kur e kishte parë se atë nuk e kishte shoqëruar i zoti i shtëpisë.

Ukshini i kishte bërë shenjë me krye sikur t’i kishte thënë, ti e di më mirë dhe e kishte drejtuar mysafirin e paftuar të natës drejt sallonit, i cili ishte i zbrazur. Vetëm në pjesën ballore të murit në dyshemenë e shtruar me dërrasa, ishin vendosur shiltet. Ishte ndjerë keq, jo për kushtet që nuk i kishte, por nga shkakku se nuk kishte një vend ku do të uleshin thjesht për të biseduar, sepse i kishte ardhur mërzi që të uleshin në shiltet ku ai flinte.

Në çast iu kujtua se R-ja i kishte sjellë dy karrige dhe një tryezë të vogël të kafesë, në mënyrë që ata të mund të pinin kafe e të bënin muhabet duke qenë të ulur të paktën në karrige. Kur ishte çuar për të shkuar në shtëpi, ai i kishte vendosur ato në kuzhinë, sepse e dinte se do ta pengonin Ukshinin kur ai do të shëtiste poshtë e lartë sallonit, siç e kishte zakon të ecte nëpër odën e Zyfës kur ishte vetëm.

Pa humbur kohë dhe i gëzuar për këtë mundësi, i kishte marrë që andej dhe ia kishte ofruar gjeneralit njëren karrige që të ulej. Më pas e kishte sjellë edhe tryezën e kafesë dhe me atë rast iu duke se i kishte tashmë të gjitha gjërat e nevojshme, pavarësisht faktit se nuk e kishte hapur ende as ujin në kuzhinë. Ai e dinte se vetëm një orë më parë, aty kishte qenë R-ja dhe ai do ta kishte pastruar me siguri inventarin përcjellës të kafesë, dhe, duke i kërkuar falje gjeneralit, i kishte thënë se ai do t’i bënte kafetë, e më pas do ta dëgjonte tjetrin krejt çfarë kishte për të thënë.

Ukshini kishte filluar t’i sqaronte mysafirit të paftuar fillimisht se ai ende nuk kishte dalë në shtëpinë e re, por e shfrytëzonte atë kohë për të bërë rojën e shtëpisë. I kishte ndodhur që brenda saj hynin të rinjtë, pinin, madje disa edhe

Rexhep Hoti

bënin dashuri dhe sa herë që vinte në mëngjes, i duhej të merrej me pastrimin e saj.

Më të vështirë e kishte largimin e prezervativëve, ndaj të cilëve lëshonte sharje të rënda. Ndonëse shpjegimi i ishte dukur shumë i mërzitshëm, dhe ai as që do të duhej të fliste diçka të tillë me zyrtarin e ushtrisë, natyra e atij komunikimi i jepte kohë për ta kuptuar shkakun e ardhjes së njeriut të errësirës. Kjo ishte një metodë analitike që e kishte përvetësuar përgjatë kohës sa kishte qenë për specializim në Harvard, të përfitosh dhe të pushtosh realitete të panjohura pa pasur informacione paraprake nga pala tjetër, pavarësisht nga e dhëna se tashmë e dinte nga ishte pika e nisjes së gjeneralit. Burimi ishte te koha e proceseve hetuese në Burgun Qendror të Beogradit.

“Nuk ke çfarë i bën, zoti Ukshin, e ardhmja është e tyre, e kaluara e jona”, ia kishte bërë ai dhe kishte buzëqeshur pak, për të shtuar më pas: “E tash më lejoni që të prezantohem! Unë quhem gjeneralmajor S. i ushtrisë jugosllave pranë Shtabit të Përgjithshëm. Jam i lindur në Krlevë. Bëj pjesë në përgjegjësinë e sektorit të mekanizuar të këmbësorisë. Gjithashtu dua të kërkoj falje për ardhjen kaq të vonshme, por këtë e kemi bërë për të mos ju vënë në pozitë të palakmueshme edhe ju, duke i ditur rrethanat politike që mbretërojnë tash e një kohë. Edhe njëherë ju kërkojmë falje për vizitën kaq të vonë, e të paparalajmëruar”, i kishte thënë gjenerali serb duke u përpjekur që ta ruante thjeshtësinë. Para se ta ndizte vetë një cigare ia kishte ofruar edhe gjeneralit, i cili e kishte marrë me kënaqësi. Ishte një rrethanë krejt e veçantë për të, duke filluar nga ambienti e deri te pozitat që kishte në raport me njeriun që duhej ta mbante nën kontroll, me natyra të ndryshme të përkatësive etnike, e deri te dallimi i karaktereve.

“Zoti gjeneral, ju mund të mos e dini ndoshta, por te shqiptarët shtëpia është e Mikut dhe e Zotit, ndaj ndihuni si në shtëpinë tuaj, sepse ju jeni miku im, pavarësisht prej misionit

Kohë e prerë

që mund të keni”, e kishte filluar bisedën Ukshini. “Sa i përket mosparalajmërimit, më lejoni të ju kujtoj se edhe kjo nuk është e saktë. Ju më keni paralajmëruar nëpërmjet këshilltarit tuaj, zotërisë Zvonko Obradović që në kohën e procesit hetues në burgun Qendror të Beogradit.”

Gjenerali serb për një çast shtangu, se si e kishte kapur tjetri paralajmërimin.

“Ua, vërtet ashtu është! Më paska dalë nga mendja”, i kishte bërë ai pa e fshehur befasinë. “Më lejo që të kthehem te dy parimet tuaja për mikun e shtëpisë. Më duken shumë të çuditshme, por edhe tërheqëse njëkohësisht! Nga ana ime si serb, që shtëpinë e vlerësojmë si një përkatësi të shenjtë, brenda së cilës jeton intimiteti origjinal i çdo familjeje, më bën të ndihem njeri shumë i privilegjuar. Gjersa jam te ju, pra në një familje shqiptare. Nuk dua të më keqkuptoni, por përkatësia dhe intimiteti nuk mund të ndahen lehtë. Nga këto orë të pasmesnatës do të kem tjetër mendim për shqiptarët, pavarësisht asaj se relacioni ynë zyrtar nuk ndryshon gjë. Nga ana private ndihem shumë i prekur, më besoni, nga kjo praktikë e traditës suaj.”

Një erë që kishte filluar të frynte jashtë kohë më parë, kishte filluar të dëgjohej tashmë edhe brenda, sikur ta kishte humbur durimin e padukshmja e ajrit. Mirëpo, në çastet e para të ndryshimit të motit, as Ukshini dhe, as gjenerali nuk e kishin vëmendjen te kushtet e jashtme atmosferike, që po ndryshonin. Dukej sikur natyra dëshironte të mos linte njeri përjashta në Krushë të Madhe, gjersa të mos mbaronte vizita e çuditshme e njerëzve me shtet të fuqishëm, siç ishte gjenerali dhe djalit të madh të Zyfës, të rënë nga qiejt e lartë të botës akademike e politike në truallin e Perzhinës.

“Edhe po të dëshiroja ta bëja ndryshe, s’do të mundja ta bëja dot”, kishte ndërhyrë qetë Ukshini. “Ky është zakoni ynë i lashtë dhe unë ndihem i nderuar që kam rastin ta respektoj kodin e vjetër të të parëve tanë edhe në rrethana më të veçanta,

Rexhep Hoti

çfarë do të mund të cilësoheshin në këtë rast ato me ardhjen e një gjenerali. Aq më tepër që edhe nga aspekti filozofik i vlerësuj këto dy parime themelore të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Mendoj se është një lashtësi me një botë të zgjedhur dhe e cila nuk mund të ruhet as në UNESCO apo diku tjetër ngjashëm, po vetëm në përditshmërinë e shpirtit të një populli. Uroj nga zemra që ta kultivojnë këtë vlerë shqiptarët e mi, sado që të ikin drejt postmodernizmit”, kishte përfunduar Ukshini, i cili kishte pasur për qëllim që ta bënte të ndihej mirë mysafiri i rëndë i shtetit të Jugosllavisë dhe Serbisë bashkë.

Jashtë kishte filluar të binte një shi i rehatshëm sikur të kishte pritur orët e pasmesnatës për ta lëshuar ngarkesën e lagshtë në tokë. Përplasja e pikave edhe nëpër xhamat e dritareve, kishte qenë e pamundur që të mos vihej re edhe prej shpërfilljes së gjeneralit dhe Ukshinit. Këtij të fundit i ishin kujtuar dy ushtarët që rrinin përjashta dhe, aty për aty, i ishte drejtuar gjeneralit:

“Po që se dëshiron mund të vijnë edhe ushtarët brenda që të mos i lagë shiu.”

“Mirë janë ata”, ia kishte kthyer ai. “Fundja edhe kjo punë është në natyrën e mandatit të përgjegjësive që kanë. Megjithatë faleminderit shumë për kujdesin dhe mikpritjen.”

Gjenerali serb kishte heshtur disa sekonda, por ende pa filluar të fliste tjetri, i cili vihej re se do të shtonte diçka, e kishte vazhduar bisedën sërish. Mirëpo, e folura e tij këtë radhë ndërli dhej me qëllimin e ardhjes në shtëpinë e Ukshinit dhe ai, si ushtarak, i kishte shkoqitur pikat saktë dhe një nga një. Ia kishte shpjeguar me durim katër pika kryesore, ashtu siç kishte qenë i njoftuar edhe gjatë kohës gjersa kishte qenë në burgun hetues. Pika e parë: Ukshini do të ishte nën vëzhgimin e ushtrisë. Pika e dytë: nuk do të lejohej të futej në politikë. Pika e tretë: s’do t’i lejohej të jetonte jashtë Krushës së Madhe. Pika e katërt: nuk do t’i lejohej të migronte jashtë vendit. Gjenerali

Kohë e prerë

i kishte shkoqitur pikat me saktësi të jashtëzakonshme, për të mos lënë hapësirë për keqkuptime më vonë.

“Ne jemi të gatshëm në çdo kohë që ju do të dëshironit, ta shtrijmë bashkëpunimin me ju dhe, me atë rast, mund t’i përcaktojmë më konkretisht edhe format e një partneriteti të tillë. Nuk e kemi fshehur dhe nuk e fshehim qëllimin se ne kemi interes që ju ta drejtoni Kosovën, por sipas përcaktimeve tona. Në të kundërtën, duhet t’i respektoni kufizimet që ju thamë më lart. Nën kushtet e zbatimit të pikave që ju përmend, ju garantoj se kurrë s’do të ndodhë gjë me ju. Jashtë tyre s’mund të garantoj, as për vete e as për ju. Koncepti i juaj në vete ka dy elemente boshtore, që ne nuk mund t’i lejojmë: është separatist përballë të ardhmes së Jugosllavisë, dhe është irredentist sepse e dëshironi bashkimin me shtetin tuaj amë.”

Duke i pasur të njohura të dhënat se ekspertët jugosllavë, veçmas ata serbë, i kishin të qarta mendimet për konceptin e tij mbi filozofinë politike të çështjes shqiptare, nuk i ishte dukur e arsyeshme që të lëshohej në diskutim në shtëpinë e tij me gjeneralin serb. E kishte dëgjuar me kujdesin më të madh, dhe, në fund e kishte falënderuar që ia kishte shpalosur pa dykuptimësi kushtet e një ostracizmi politik, që ngjanin në të vërtetë me kushte mesjetare të inkuizicionit, sikur Ukshini të ishte ndëshkuar për herezi nga kisha. Kur dera e hyrjes ishte mbyllur dhe Ukshini kishte mbetur vetëm me zbrazëtinë e shtëpisë, nuk po mund ta besonte ende kthjelltë, se një paralajmërim gjatë kohës së burgut hetues, po bëhej realitet edhe pas daljes së tij nga burgu, ashtu siç e kishte parashikuar këshilltari i gjeneralit para shumë vitesh. Nuk e kishte besuar se shpikja e tij në lidhje me “Brigadat e Kuqe” të ishte bërë shkak.

Por, nuk e kishte vlerësuar aq lart as shkallën e rrezikshmërisë që paraqiste ai për të ardhmen e Jugosllavisë, sa të merrej kreu politik i armatës jugosllave dhe serbe me të intensivisht edhe pasi të dalë nga burgu. Ndërsa po e përplaste

Rexhep Hoti

mendimin nëpër vite dhe pozicionimin e tij edhe pasi ishte liruar nga burgu, i ishte kujtuar edhe Lekë Dukagjini dhe gjithë ajo përmbledhje nenesh të vjetra te dokeve dhe zakoneve shqiptare, prej të cilave kishte aq shumë përkufizime, dispozita e akte normative, sa në çast i ishte dukur sikur Kanuni të kishte pasur në lidhje transcendentale me botën reale të kodit gjenetik të shqiptarët. I një natyre të tillë sikur të kishin depërtuar pjesë të caktuara të gjeneve në kodin kanunor, si informacione të koduara. Madje edhe fragmente të gjeneve që shfaqin ndikimet e jashtme kohore të trungjeve të tjera etnike, pra të qytetërimeve ku ata kishin qenë ndërtues e jo shërbyes të tyre. Natyrisht nga ndikimet e jashtme kishte hyrë shumëçka e herrur. Eh, Lekë Dukagjini, kishte thënë me vete, çfarë thonë nenet e tua kur të troket te dera një gjeneral, i cili ma shndërron vendlindjen në kullë ngujimi, pavarësisht nga e dhëna se e kam shlyer dënimin për shprehjen e mendimit tim të lirë, po sipas ligjeve që i kanë miratuar vetë ata. Madje shumë më shumë sesa kaq?! Ishte shtrirë në shilte dhe në çastin që i kishte mbyllur sytë, iu kujtua se në mesnatë do të duhej t'i vinte znj. L. për vizitë.

Por, ajo nuk kishte ardhur. Ndoshta do ta ketë penguar shiu, mendoj me vete dhe i kishte mbyllur sytë për ta mashtruar gjumin. Në të vërtetë ai rrinte zgjuar me sy mbyllur, si në të shumtën e rasteve dhe e imitonte gjumin nëpërmjet pagjumësisë, pavarësisht asaj se e kishte të qartë kristal se mashtrimi i vetes ishte puna më e vështirë dhe pothuaj e pamundur, që ai e kishte konstatuar tash e kohë më parë. Idiot, iu bë se e përfoli me vete këtë fjalë, padashur ta saktësoj rrjedhën e saktë që atij qortimi.

Frymëmarrjen e Dyrre Jollës nëpër rrugën e Celinës, i cili po shkonte në drejtim të qendrës së Krushës së Madhe, do të mund ta dëgjonin kalimtarët e rastit pa asnjë telash edhe po

Kohë e prerë

të ishin dhjetë apo pesëmbëdhjetë hapa larg tij. Arsyeya që ai nuk po ngopej dot me ajër, nuk ishte për shkak të moshës që kishte, pavarësisht asaj se po linte prapa të shtatëdhjetat dhe po ngjitej drejt të tetëdhjetave. Ai kishte qenë në një mision të shkurtër, por të cilin nuk do të kishte mundësi ta ëndërronte kurrsesi më parë.

Pa asnjë paralajmërim para shtëpisë së tij kishte ndaluar picgauveri ushtarak, prej të cilit kishte dalë një ushtar dhe e kishte lutur me mirësjellje që të shkonte pas tij. Vetëm pasi ishte futur brenda në makinën ushtarake e kishte kuptuar se duhej ta ndihmonte oficerin e lartë serb që kishte gradën e një gjenerali dhe të cilën Dyrra e kishte njohur menjëherë përmes gradës që tjetri kishte në krah. Ai duhej t'i tregonte se te cila shtëpi ndodhej Profesori Ukshin dhe ai kishte mundësi të ishte ose te shtëpia e vjetër e prindërve në odë ose në shtëpinë e re në Perzhinë, të cilën sapo e kishte ndërtuar, dhe e cila ndodhej krejt në fund të fshatit.

Natyrisht ndihma e tij ishte e detyrueshme edhe me përgjegjësitë që kishte marrë, por ai këtë radhë nuk mendoi fare për procedura të tilla për të cilat merrte edhe honorar. Ishte drejtuar së bashku me ushtarakët te kafeneja në qendër të fshatit ku rrinte informatori që quhej “Debelli”, që në gjuhën shqipe do të thoshte “I trashi”, i cili ishte një spiun lokal i fshatit dhe vinte nga gjaku i Mëhallës së Ukshinit, veçse ai nuk ishte prej anës së krahut të Fetoshëve, por ishte prej anës së krahut të Durakëve. Kishte zbritur nga makina pas magazinës së fshatit, mu aty ku ndodhej një vend i përshtatshëm për ta fshehur picgauverin dhe njëkohësisht nuk ishte larg kafenesë ku rrinte informatori i tij. E kishte marrë informacionin se atë mbrëmje Profesori ndodhej në shtëpinë e vet në Përzhinë dhe ai ndodhej tashmë vetëm, sepse para një ore kishte dalë prej tij edhe kushëriri R-ja I kishte dërguar ushtarakët në cakun tjetër pa humbur kohë dhe më pas Dyrra kishte qenë i lirë. Kur kishte mbetur vetëm e kishte kuptuar se tensioni i tij kishte shkuar

Rexhep Hoti

shumë lart. E kishte marrë me shpejtësi një hap nën gjuhë, që ishte për raste emergjente, e të cilin e mbante me vete, dhe kishte vazhduar ashtu nëpër rrugën e Cilinës, e cila e çonte drejt e në qendrën e fshatit. Në rrethana të tilla, gjatë rrugës së kthimit e kishte takuar znj. L., e cila e kishte dëgjuar më parë frymëmarrjen e dikujt që po vinte drejt saj, para se ta njihte se kush ishte njeriu që nuk po ngopej dot me frymë. Me të afruar më pranë, ajo e kishte njohur kushëririn e vet. Ishte ndierë tepër ngushtë, por kishte qenë shumë vonë që ta shmangte ballafaqimin me të. Ku dreqin ma qiti Zoti këtë spiun këtu, kishte thënë me vete. Vetëm ky s'do të duhej të më shihte kurrqysh. E detyruar, e kishte përshëndetur e para krejt qetë, sikur të mos ndodhte gjë dhe sikur të kishte qenë pika e ditës jo orë e parë pas mesit të natës. Në raste të tjera, Dyrra, do ta kishte mendjen se përse rravgonte aq vonë çika e Limanit, por ashtu siç ishte puna, nuk e kishte fshehur ndjenjën e mirë që po e takonte një njeri të njohur. Kryetari i Krushës së Madhe e kishte të njohur nga “Debelli”, se ajo takohej pas mesnate me Ukshinin dhe se kishin filluar dyshimet e para se diçka po ndodhte ndërmjet tyre. Znj. L. mbeti e habitur se si kushëririn i saj nuk shprehu kurrfarë habie, që po e takonte atë në mesnatë fillikat.

“Kthehu me mua bija ime”, i kishte thënë asaj, duke u munduar që t'i bënte hapësirë edhe fjalëve që thoshte e edhe frymëmarrjes së rënduar. “Ukshini ka mysafirë, një gjeneral të ushtrisë dhe dy ushtarë. Sonte nuk është nata për ty atje”, i kishte thënë, duke bërë me dorë kah gjoksi, që po i ngrihej dhe ulej nga vështirësitë e frymëmarrjes, sikur gjoksi i tij të ishte një magmë vullkanike para shpërthimit. Ajo kishte dashur ta pyeste për shëndetin, por kur e kishte vënë re se ai do të fillonte të fliste prapë, kishte heshtur dhe në hap me të ishte kthyer në drejtim të qendrës.

“Sapo e piva një hap të tensionit. Aso që merret nën gjuhë. Dësh vdiqa. Jam shumë i tronditur. S'di si më erdhi aq

Kohë e prerë

papritur. Djali i Zyfës me gjithë ato vite burg me gjeneralin serb, pah, pah, pah... Më duket e pabesueshme. Ruajuna, o Zot”, i thoshte znj. L. në atë mënyrë, sikur të fliste me vete e jo me të.

Çika e Limanit e veshur me një kostum të zi mbi gjunjë dhe këmishë të bardhë nuk fliste gjë. Meqë nuk e kishte kundërshtuar Kryetarin kur i kishte dhënë për të kuptuar se ai e dinte që ajo ishte nisur për tek Ukshini, të tjerat ishin më të lehta për t’i dëgjuar në heshtje më pas. Ende pa hyrë në pjesën e rrugës e cila shndërrohej edhe në shesh të fshatit, ajo fillimisht i kishte fshirë të kuqtë e buzëve me një leckë që e mbante në pjesën e brendshme të kostumit dhe po përgatitej që para se t’i binin dritat e shumta të shtëpive, të dukej sa më normale dhe më pas e kishte gjetur edhe kohën e përshtatshme, që, më në fund, ta pyeste tjetrin nëse i kishte kaluar tensioni dhe nëse ndihej më mirë me shëndet pasi e kishte marrë tabletën.

“Ma mirë jam, ma mirë”, ia kishte kthyer Dyrra, ndërsa kishte menduar me vete: ah moj çika e Limanit, po shpejt u kujtove për shnetën e bacës se...

Kreu i dytë

Hrrësira gjatë gjithë kohës, derisa ata rravgonin si zakonisht dhe pa asnjë qëllim të caktuar paraprak, shoqërohej nga një erë e ngrohtë, e cila e bënte të padurueshëm ajrin për udhëtarët e orëve të vona. Ata ishin detyrimisht të mësuar dhe të pajtuar tashmë me nxehtësinë e natës, e cila ziente në vetvete, edhe kur frynte lehtë. Në vend që mbi fytyrën e tyre të rrëshqiste fladi i mesnatës, ata e ndienin valën e nxehtë të ajrit, si të çapiteshin pranë një banje termale të natyrës. U ishte bërë shprehi gjykimi i kësaj gjendjeje, sepse ishte shumë e bezdisshme për rrugëtim nëpër natë.

Ukshini e kishte zakon të shikonte lart nga qielli sikur të dëshironte ta saktësonte shkakun se prej nga vinte gjithë ajo nxehtësi edhe pas mesnate. E hidhëronte më të vërtetë vapa. Mendonte se nëpër fushat e bukura të Përdrinisë, gjithçka do të duhej të ishte më e freskët në atë kohë. R-ja, që ishte mësuar me këtë rremb të motit prej kohësh, pavarësisht asaj se ishte shumë më i ri në moshë, sepse qysh si gjimnazit ishte mësuar të flinte natën në fushë me muaj të tërë, mahitej me Profesorin duke e parë ngrohtësinë e errësirës së natës si një simbolikë, çka do të thotë se diku prapa saj fshihej zjarri që prodhonte energji të mjaftë edhe për thellësinë e natës. Dielli nxehte aq shumë gjatë ditës sa mjaftonte që të mos harrohej ngrohtësia e tij

Rexhep Hoti

derisa lindte përsëri. Përgjatë natës nxehtësia ngrihej nga poshtë dhe e pushtonte sërish fushnajën e pëlleshme, e cila gumëzhinte nga ujitja e pipave, si të ishte fusha e Krushës së Madhe e tëra me koshere bletësh.

Nata kishte kohë që e kishte shtruar pushtimin poshtë luginave dhe fushave të Anadrinisë, kur Ukshini, së bashku me R-në, arritën të udhëkryqi kryesor i fshatit. Dikur ata ktheheshin në të djathë, sepse andej ishte shtëpia e vjetër e babait të Ukshinit, por, po atje, ishte edhe shtëpia e parë që bashkëfshatarët e të afërmit ia kishin ndërtuar Ukës sapo ai kishte dalë nga burgu. Pra ishte shtëpia e vjetër e prindërve dhe pranë saj ishte shtëpia e re, e madhe, e ndërtuar për Ukshinin me ndihmën e bashkëfshatarëve. Duke qenë i papunë dhe pa kurrfarë të ardhurash nuk kishte munguar mbështetja financiare e të gjithëve. Mirëpo, pasi ajo u mbulua edhe me kullm, atëherë atë ia mori i vëllai i dytë, që vinte fill pas tij për nga mosha.

Pati shumë fjalë se si ndodhi ky ndërrim i papritur i pronarit të shtëpisë, pasi ajo ishte ndërtuar në shenjë solidariteti për njeriun që sapo kishte dalë nga burgu. Përkushtimi i të gjithëve që ndihmuan kishte qenë vërtet i madh dhe i pakursyer. Ata që e kishin ofruar ndihmën, e kishin bërë një hap të tillë për t'ia lehtësuar gjendjen, për aq sa ishte e mundur, njeriut të sapokthyer në fshat, pavarësisht faktit se mbretëronte frikë e madhe dhe terror i paparë shtetëror, edhe ndaj atyre që identifikoheshin si mbështetës të të dënuarve politikë. E veçmas kjo shikohej me një thjerrëz tjetër kur bëhej fjalë për Ukshinin. Pushteti komunist i KSA-së së Kosovës, fillimisht i mbështetur fuqishëm edhe nga Republika e Serbisë dhe federata jugosllave, i kishte filluar ndëshkimet masive për pjesëmarrësit e demonstratave të vitit 1981.

Ishte ky një proces brutal policor, prokurorial e gjyqësor, i cili sa më shumë që kalonin vitet, aq më i rëndë, më masiv e më tmerrues bëhej, si për njerëzit, ashtu edhe për autonominë

Kohë e prerë

e shtetit të Kosovës, për institucionet e saj. Shteti fqinj, Serbia, fillimisht me kuadrot e etnisë së vet në Kosovë, kishte filluar t'i avanconte proceset për t'i vendosur gjithnjë e më shumë kuadrot me përkatësi serbe në pozicione drejtuese, si në rrafshin e politikave krahinore e po ashtu edhe në drejtim të politikave komunale. Dhe pikërisht këtë strategji të Serbisë po dështonte ta kuptonte ose kishte frikë ta kuptonte klasa politike, përgjithësisht establishmenti i Kosovës për ta mbrojtur autonominë e shtetit.

Kur Ukshini ishte liruar nga burgu më 1985, Serbia ndodhej në hovin e madh për t'ia marrë kompetencat e autonomisë. Një vit më vonë erdhi edhe zyrtarisht në politikë Slobodan Millosheviqi, i cili së pari e rrëzoi klikën e stambolliqëve në Serbi, që ishte një shenjë e fuqishme se njeriu në ardhje e sipër, nuk ishte mahi për askënd në kuadër të Jugosllavisë e jo vetëm për shqiptarët e Kosovës. Krahas gjendjes së zymtë dhe të pashpresë që Ukshini e shihte në rrafshin politik, me lirim nga burgu, kishte marrë me vete edhe telashe të tjera personale e familjare, që e kishin zanafillën që në kohën sa ishte në burg.

Sikur gjendjes së tij të rënduar të mos i mjaftonte vetëm goditja nga politika, por i duheshin medoemos edhe telashe familjare për t'u njësuar e keqja në hapësirën kudo që do të shkelte këmba e tij. Duke e korrigjuar qëndrimin e vet vetëm pak kohë para se të lirohej nga burgu, në lidhje me kërkesën e mëhershme që e kishte bërë para disa muajsh për t'u shkukurëzuar zyrtarisht me Edin, nuk ia kishte dalë megjithatë ta evitonte ndarjen, pasi i ishte penduar më vonë. E kishte shpresuar kthimin tek Edi, qysh natën e parë të daljes nga burgu dhe dera e parë që kishte trokitur kishte qenë ajo e apartamentit të vet në Ulpianë.

E shoqja ia kishte hapur derën, e kishte pritur brenda, i kishte shërbyer kafë dhe më pas i kishte thënë shkoqur se ose ai ose ajo me vajzën e vogël duhej që të dilnin nga apartamenti.